

**VENDIM**  
**Nr. 445, datë 3.6.2020**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 780, DATË 6.11.2019, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E OFICERËVE KOORDINUES, PËR ÇËSHTJET**  
**E DIASPORËS SHQIPTARE, NË KONSULLATAT SHQIPTARE NË ITALI DHE**  
**GREQI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 4, të vendimit nr. 780, datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Përjashtimisht, për vitin 2020, efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Diasporës.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**